



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.431/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Ramush Bardiqi dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga [REDAKTUAR] nga Prishtina, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me mos përfshirjen e vajzës sa saj, [REDAKTUAR], në listën përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datën 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më 09.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet e pasafatshme ankesa Anr.431/2025, e datës 07.02.2025, e parashtruar nga [REDAKTUAR] nga Prishtina, me të cilën kërkon që vajza e saj, [REDAKTUAR] të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i ka pranuar ankese nga [REDAKTUAR] nga Prishtina, në të cilën theksohet se vajza e saj [REDAKTUAR], ka qenë e përfshirë në listën përfundimtare të votuesve brenda Kosovës, e njëjta ka votuar në Zgjedhjet e vitit 2019 dhe 2021. Ndërsa tani për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, tani të njëjtës iu është mohuar e drejta e votimit. Më tej në ankesë thekson se [REDAKTUAR], për shkak të trashëgimisë së pasurisë i është hequr pjesërisht zotësia për të vepruar, sa i përket të drejtave të saj pasurore për shkak të diagnozës Sindrom Daën, mirëpo e drejta për të votuar nuk i është hequr me asnjë vendim të gjykatës. Kërkon nga PZAP-i që të bëjë përfshirje saj në listën përfundimtare të votuesve brenda Kosovës.

Në përgjigjen në ankese të KQZ-se, theksohet se në bazë të kërkesës tuaj e dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me datë 07.02.2025, Nr.07/6-531/2025, lidhur me kërkesën në A.nr.431/2025, të datës 07.02.2025, për përgjigje në Ankese të parashtruar nga [REDAKTUAR] nga Prishtina Prishtinë, lidhur me mos përfshirjen e Listës Përfundimtare të Votuesve. KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj ju njofton, si në vijim: KQZ, 16 gusht 2025, bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr.03/2024, Krijimi dhe Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës Votuese neni 3 paragrafi 4, ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të dorëzojë listën e personave të cilëve, u është marrë

zotësia e veprimit me vendim gjyqësor e cila listë duhet të pranohet nga KQZ jo më vonë se shtatë (7 ditë) pas shpalljes së datës së zgjedhjeve. Të dhënat personale të këtyre personave duhet të përfshijnë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal dhe adresën. Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga data 30 gusht deri më 11 shtator 2025, ka dorëzuar KQZ -së listën me emër, mbiemër, date të lindjes dhe numër personal të personave të cilëve, u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor. Ku në këtë listë figuron edhe emri i znj. [REDAKTUAR] nga Prishtina. Shërbimi votues, pas listës së dorëzuar nga KGJK, bazuar nën 3 paragrafi 5 i Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024, Krijimi dhe Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës Votuese, ka larguar nga Lista Përfundimtare Votuesve (LPV) emrat e personave që me vendim gjyqësor të formës së prerë u është marrë zotësia e veprimit. Bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, afati për parashtrimin e ankesave ndaj vendimeve të KQZ-së është 48 orë nga marrja e vendimit të kontestuar. Meqenëse vendimi për Certifikim në LPV është marrë më 4 janar 2025, ndërsa ankesa e ankueses është dorëzuar më 07 shkurt, kjo nënkupton se është tejkaluar afati i përcaktuar ligjorisht. Andaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura si më sipër, si dhe dispozitat ligjore të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nëni 119 paragrafi 1 kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) që pretendimet e palës ankuese ti i hedhë si të pasafatshme. Si dëshmi kane bashkangjitur: Vendimin e KQZ-së Nr.01/19-2025, të datës 04.01.2025, për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2024.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës vëren se ankesa e ankueses është e pasafatshme.

Neni 10 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme për në Republikën e Kosovës, përcakton se çdo person me të drejtë vote siç përcaktohet me nën 6 të këtij ligji, që nuk figuron në listën e votuesve mund të kërkojë nga KQZ-ja rishikimin e listës së votuesve, duke u paraqitur në KKZ apo përmes sistemit elektronik, ndërsa paragrafi i 3 i këtij neni thekson se personi që edhe pas rishikimit nuk është përfshirë në listën e votuesve mund të dorëzojë ankesë në PZAP, brenda afatit prej 48 orësh, nga momenti kur është njoftuar për mos përfshirjen e emrit të tij në listën votuese, deri në certifikimin e listës votuese nga KQZ-ja.

Prandaj sipas vlerësimit të Panelit pala ankuese para certifikimit të listës së votuesve nga KQZ me vendimin e datës 04.01.2025, ka marrë vendim për certifikimin e listës përfundimtare të votuesve, kurse ankesën në PZAP e ka ushtruar më datë 07.02.2025. Pra gjatë gjithë kësaj periudhe kohore ankuesja nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ka paraqitur ndonjë kërkesë për rishikimin e listës së votuesve me të cilën ka kërkuar përfshirje të vajzës së saj, [REDAKTUAR] në listën e votuesve, e rrjedhimisht nga ka lëshuar afatin ligjor prej 48 orëve për të kontestuar vendimin e KQZ-së certifikimin e listës përfundimtare të votuesve të datës 04.01.2025, në PZAP.

Meqenëse vendimi i KQZ-së për Certifikim e Listës Përfundimtare të Votuesve është marrë më 4 janar 2025, ndërsa ankesa e palës ankuese në PZAP është dorëzuar më 07 shkurt 2025, nga kjo rrjedh se është ankesa e parashtruar është e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragraf 1 dhe nenit 119 paragrafi 1, i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.2 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr.431/2025, datë 09.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

